



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 658 Prot.

Tiranë, më 14/4 /2017

VENDIM

Nr. 64, datë 14/4 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 1372 Prot., datë 30.11.2016, ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Ura Vajgurore” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, me shkresën e datës 28.10.2016 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

1. *Kontrata e pastrimit aktualisht në zbatim.*
2. *Rezultati, renditja e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit që kanë prodhuar këto kontrata, së bashku me informacionin për skualifikimin e mundshëm dhe ankimet e operatorëve pjesëmarrës në procedurë.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1372, datë 30.11.2016 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1372/1 Prot, datë 06.12.2016, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 14.12.2016.

Autoriteti Publik është përgjigjur me shkresën nr. 2216/2 Prot., datë 12.12.2016, duke vendosur në dispozicion të kërkuarit informacion në lidhje me pikën e dytë të kërkesës.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 1372/3 Prot, datë 27.12.2016, Qendra “Res Publica” ka vijuar ankimin duke kërkuar vazhdimin e shqyrtimit të ankesës në lidhje me pikën e parë të kërkesës, “Kopje të Kontratës së pastrimit aktualisht në zbatim”.

Komisioneri, pas konsultimit të legjislationit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica”, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim quajtur “Ligji për të Drejtën e Informimit”), sipas të cilit “informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik” dhe si i tillë, dhënia e tij nuk mund të refuzohet.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’.

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit të Qendrës “Res Publica”, Nr. 1372 Prot., datë 30.11.2016, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Ura Vajguore”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik “Bashkia Ura Vajguore”, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (Kopje të Kontratës së pastrimit aktualisht në zbatim), brenda datës 24. 4. 2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u dha sot në datë 14. 4. 2017.

